



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:030308
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06153417

K.DH.SH.II.nr.1529/24

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryetar, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri anëtarë në çështjen juridike të propozuesit të sigurimit Sh.D., me adrese në Prishtinë, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Qëndrim Arifi, avokat në Prishtinë, kundër kundërshtarëve të masës të sigurimit 1. J.P., me adresë në Prishtinë, rruga 2, L.Zh., me adresë në Podujevë rruga ..., pn. dhe 3. MEDPLUS Shpk me NUI 811867441, me seli në Lebanë, rruga Pranvera e Lirisë, pn. te cilën sipas autorizimit i përfaqëson Marigona Berisha, avokate në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarëve të masës së sigurisë dhe kundërshtarëve të masës së sigurisë-(palëve ndërgjyqëse) të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomave të shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.67/2024 i datës 19.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 11.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuara ankesat e propozuesit të sigurimit Sh.D., me adrese në Prishtinë dhe kundërshtarëve të masës të sigurimit 1. J.P., me adresë në Prishtinë, rruga 2, L.Zh., me adresë në Podujevë rruga ..., pn. si dhe 3. MEDPLUS Shpk me NUI 811867441, me seli në Lebanë, rruga Pranvera e Lirisë, pn.

II.VËRTETOHET Aktvendimit i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.67/2024 i datës 19.06.2024.

A R S Y E T I M

Me aktvendimin e atakuar të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike ka vendos: "Aprovohet pjesërisht si i bazuar propozimi i propozuesve të

masës së sigurimit: Sh.D., me numër personal 1500570942, me vendbanim në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar të Caktohet masa e sigurimit ashtu që të PEZULLOHET Vendimi i datës 28.12.2023 dhe vendim i datës 18.03.2024 të Kuvendit të Aksionareve të Medplus sh.p.k. Refuzohet pjesërisht propozimi i propozuesve me të cilën ka kërkuar të kushtëzohet vendimmarrja në kuvendin e aksionareve të MEDPLUS SHPK me votë unanime të të gjithë aksionareve sa i përket pagave të aksionareve dhe paga të personave të tretë të cilët mund të punësohen në këtë kompani. Kjo masë e sigurimit vlen deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankese kundërshtaret e masës së sigurimit, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata të aprovoj ne tersi ankesën si të bazuar, të Ndryshohet pika I e dispozitivit të aktvendimi të atakuar dhe të refuzohet e propozimi për caktimin e masës së sigurisë i paraqitur nga propozuesi Sh.D. kundër 1. J.P., me adresë në Prishtinë, rruga 2, L.Zh., me adresë në Podujevë rruga ..., pn. si dhe 3. MEDPLUS Shpk me NUI 811867441, me seli në Lebanë dhe pezullohet vendimi i dt. 30.06.2023 i kuvendit të aksionareve të Medplus shpk.

Kundër aktvendimit të ankimuar ankese ka parashtruar edhe propozuesi i masës së sigurisë me të cilën ka kërkuar të shqyrtoj kërkesën të paraqitur kundër kundërshtarëve të sigurimit me të cilën kishte kërkuar të kushtëzohet vendimmarrja në kuvendin e aksionareve të MEDPLUS SHPK me votë unanime të të gjithë aksionareve sa i përket pagave të aksionareve dhe paga të personave të tretë të cilët mund të punësohen në këtë kompani. Kjo masë e sigurimit vlen deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesit/paditësit, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar propozim për caktimin e masës së sigurisë me të cilën kanë kërkuar aprovohet propozimin e propozuesit të masës së sigurisë ndaj të paditurave kundërshtarëve të masës së sigurisë Caktohet Masa e sigurimit ndaj kundërshtarëve të sigurimit 1. J.P., me adresë në Prishtinë, rruga 2, L.Zh., me adresë në Podujevë rruga ..., pn. si dhe 3. MEDPLUS Shpk me NUI 811867441, me seli në Lebanë me të cilin ka kërkuar të caktohet masa e sigurimit ashtu që të pezullohet Vendimi i datës 28.12.2023 dhe vendim i datës 18.03.2024 të Kuvendit të Aksionareve të MEDPLUS SH.P.K. dhe të kushtëzohet vendimmarrja në kuvendin e aksionareve të MEDPLUS SHPK me votë unanime të të gjithë aksionareve sa i përket pagave të aksionareve dhe paga të personave të tretë të cilët mund të punësohen në këtë kompani.

Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë- me aktvendimin e atakuar ka aprovuar pjesërisht si e bazuar propozimi i masës sigurisë Sh.D., Caktohet Masa e sigurimit ndaj kundërshtarëve të sigurimit 1. J.P., me adresë në Prishtinë, rruga 2, L.Zh., me adresë në Podujevë rruga ..., pn. si dhe 3. MEDPLUS Shpk me NUI 811867441, me seli në Lebanë dhe pezullohet vendimi i dt. 30.06.2023 i kuvendit të aksionareve të Medplus shpk. Ndërsa në piken II të dispozitivit është refuzuar pjesërisht si pabazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit Sh.D. i paraqitur kundër kundërshtarit të sigurimit 1. J.P., me adresë në Prishtinë, rruga 2, L.Zh., me adresë në Podujevë rruga ..., pn. si dhe 3. MEDPLUS Shpk me NUI 811867441, me seli në Lebanë me të cilën ka kërkuar që të pezullohet pozita e Drejtorit Menaxhues të Korporatës të Medplus shpk, të pezullohet e drejta vendimmarrjes në Korporatën Medplus shpk të bllokohen të gjitha Llogarite bankare në emër të Korporatës Medplus shpk, si dhe të detyrohen institucionet Bankare Komerciale që të bllokojnë çdo transaksion të Korporatës Medplus Shpk në drejtim të palëve të treta. Masa e sigurimit mbetet në fuqi derisa mos të jepet vendimi tjetër mbi masën e sigurimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë i pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kolegji i kësaj gjykate sa i përket piken një (I) të dispozitivit të aktvendimit të atakuar refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të kundërshtarit të masës së sigurisë për arsye se, edhe kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në rastin konkret plotësohet kriteri ligjor për caktimin e masës së sigurimit sepse paditësit/propozuesit e masës së sigurimit kanë ofruar prova të mjaftueshme se kundërshtarët e sigurimit me caktimin e pagave të larta për përfitime personale e me të cilat mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të shoqërisë tregtare, kanë shkelur detyrimet ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 258 të ligjit nr. 06/1-016 për shoqëritë tregtare. Po ashtu kolegji vlerëson se edhe kushti i dytë ligjor është plotësuar nga neni 297.1 i nenit pika b se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do të shkaktohet dem i konsiderueshëm i cili nuk do të mund të riparohet, nga shkak se me vazhdimin e shfrytëzimit të të ardhurave të shoqërisë për përfitime e pagave të larta për interesa personale do të mund të rrezikohet stabilitetin financiar i shoqërisë, me të cilin do të ndikoj negativisht në të drejtën e propozuesit. Në rastin konkret lidhur me piken një (I) të dispozitivit të vendimit të atakuar gjykata i pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se kjo e fundit e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për aprovimin e pjesërisht të caktimit të masës së sigurimit. Kjo për faktin se ka rezultuar se propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshme në masë të mjaftueshme ekzistimin e kërkesës respektivisht të drejtës së saj subjektive, e po ashtu e ka argumentuar faktin se propozuesit mund të shkaktohet dem nëse nuk caktohet masa e sigurisë.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të propozuesit të masës së sigurisë-paditësit, mirëpo të njëjta i refuzoj si të pabazuara, për arsye

se gjykata e shkallës së parë drejte ka arsyetuar aktvendimin e atakuar në pjesën e refuzuar të masës së sigurisë së paditësit, dhe pajtohen të tersi qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë si ai përket bazuar ngase sipas nenit 102 të LSHT-së, Kuvendi i Aksionarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, i njëjti ushtron kompetencat dhe të drejta që u takon organeve të shoqërisë dhe nuk mund të kërkohet nga gjykata kushtëzimi i veprimtarisë së një organi më të lartë të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të cilat të drejtat dhe detyrimet janë të përcaktuar-rregulluara me Statut të shoqërisë. Për më tepër gjykata vlerëson se caktimi i një masë të tillë do të ishte kundër produktive sepse kushtëzimi i shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë bien në kundërshtim me Statutin e shoqërisë “MEDPLUS” SH.P.K , prandaj mos funksionimi i organeve të SHPK-së do ta përkeqësonte gjendjen financiare të shoqërisë e me këtë edhe do të rrezikonte më shumë realizimin e kërkesave të propozuesit, nëse këto kërkesa rezultojnë si të bazuara.

Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i konsideroi si të bazuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur shkelje në dëm të palëve ndërgjyqëse. Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë e ka pranuar vlerësimin dhe përfundimin e shkallës së parë, pasi që gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar vetëm rrethanat nga të cilat gjykata mund të nxjerrë besueshmërinë e kërkesës apo të drejtës subjektive. Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të ankueseve në ankesë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë të mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë së paditësit, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin ndryshe në këtë çështje juridike.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe si i tillë mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin 297 të LPK-së dhe nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, e që eventualisht do të mund të përbejë arsye për anulimin e këtij aktvendimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1529/24 me datë 11.09.2024

Numri i lëndës: 2024:030308
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06153417

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi d.v.